



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë –KIESA

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpall:

Thirrje Publike për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Skemën e Granteve të Inovacionit në Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK)

MINTI/KIESA do të mbështesë me mjete financiare ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe bizneset Start-Up . Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë qytetar të Republikës së Kosovës.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINTI/KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikim, të cilin mund ta gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/>, ndërsa për të aplikuar kliko këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/Security?ReturnUrl=%2F730>.

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 03.07.2026 deri më datë 23.07.2026.